

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyrat financiare dhe treguesit e Grupit Raiffeisen

Periudha e Raportimit: 30/9/2024

Sipas kërkesave të Rregullores Nr. 4, datë 1.2.2017
“Për mbikqyrjen e konsoliduar”
të Bankës së Shqipërisë

PËRMBAJTJA:

Faqe

1.	Bazat e përgatitjes dhe Përmbledhje e Politikave Kontabël	1 - 6
2.	Treguesit e rentabilitetit	7
3.	Bilanci kontabël (aktiv-pasivet) dhe zërat jashtë bilancit	8 - 9
4.	Pasqyra e llogarisë “të ardhura dhe shpenzime”	10
5.	Struktura e kapitalit rregulator	11
6.	Mjaftueshmëria e Kapitalit	12

Tiranë, më 27/11/2024

1. HYRJE

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit përgatiten në përputhje kërkesat e rregullores nr. 4, datë 01.2.2017 "Për Mbikëqyrjen e Konsoliduar" të Bankës së Shqipërisë, duke përfshirë Raiffiesen Bank sh.a. dhe filialin e saj Raiffeisen Leasing Sh.a., por duke përjashtuar filialin - Raiffeisen INVEST, Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. – sipas percaktimit që është bërë në nenin 5, pika 4(b) në këtë rregullore.

Raiffeisen Bank Sh.a., më poshtë referuar "Banka" është një institucion bankar i cili vepron në përputhje me Ligjin 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqërite tregtare" dhe Ligjin 9662, datë 18 Dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe me ligjet e tjera të rëndësishme. Banka është themeluar dhe vendosur në Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj operativ në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është bijë 100% e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri, e cila është pala kontrolluese finale.

Aktiviteti kryesor. Aktivitetet kryesore të biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë, ofrimi i qirave financiare për shoqëritë dhe individët dhe grumbullimin dhe investimin e fondeve të pensioneve vullnetare brenda Republikës së Shqipërisë.

Grupi vepron nëpërmjet një rrjeti prej 74 vendodhjesh shërbimi më 30 Shtator 2024 (31 Dhjetor 2023: 74 vendodhje shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat administrohen në 5 distrikte dhe nuk ka aktivitete jashtë shtetit.

2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në përputhje me "Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare" ("Metodologjia e Raportimit Financiar" ose "MRF") e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008 si dhe të rregullores "Për Mbikëqyrjen e Konsoliduar" i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më datë 1 shkurt 2017.

MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lekë Shqiptar ("Lek"), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme që vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut si edhe ndërtesave që mbahen me vlerë të drejtë, të rivlerësuar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Baza e konsolidimit

Konsolidimi i rezultatit financiar të Bankës me atë të Filialeve, në të cilin ka 100 për qind të aksioneve dhe politikat financiare të së cilës ushtron kontroll, bëhet duke ndjekur metodën e konsolidimit të plotë.

Të gjitha llogaritë e aktiveve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave konsolidohen plotësisht me llogaritë e të njëjtës natyrë të Bankës. Transaksionet midis Bankës dhe Filialeve eliminohen gjatë konsolidimit të pasqyrave.

Banka dhe të gjitha filialet përdorin politika kontabiliteti uniforme dhe konsistente me politikat e Grupit. Sipas natyrës së aktivitetit, filialet e Grupit kanë disa politika kontabël specifike të cilat detajohen në shënimin 3.6 për Raiffeisen Leasing sh.a.

3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

(i) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë prezantuar në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Grupit.

(ii) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	30 Shtator 2024	31 Dhjetor 2023
Dollari Amerikan (USD)	88.25	93.94
Monedha Europiane (EUR)	98.77	103.88

3.3 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si: arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë ("Banka Qëndrore").

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

3.4 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Të gjithë instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në kosto, e cila përbëhet nga vlera e drejtë e pagesës së dhënë duke përfshirë kostot e blerjes së instrumenteve financiare. Të gjithë fitimet apo humbjet e realizuara apo të përlogaritura janë përfshirë në të ardhurat neto.

Letrat me vlerë, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktueshme synohen të mbahen deri në maturim. Ato përfaqësojnë bonot e thesarit dhe bonot qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pas regjistrimit fillestar, letrat me vlerë të mbajtura për maturim, mbahen me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësime në vlerë. Amortizimi vjetor i zbritjeve apo i primeve për blerjen e letrave me vlerë të mbajtura për maturim i bashkohet të ardhurave të tjera nga investimi gjatë gjithë afatit të instrumentit në mënyrë që të ardhurat e njohura në çdo periudhë të përfaqësojnë të ardhura konstante nga letrat me vlerë.

3.4 Investime në letra me vlerë (vazhdim)

(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

(iv) Vlera e drejte

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuarra të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të filla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg. Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet në Shënimin 29 "Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare".

(v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje riblerjeje të anasjellta) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlogaritur. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes bëhen me Bankën e Shqipërisë.

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Grupi i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Grupi dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjonet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjoneve të përgjithshme, një provigjon për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Grupi nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer.

Politika huadhënëse e Grupit është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë" miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me Vendimin Nr.101, datë 27 dhjetor 2006, ndryshuar me Vendimin Nr. 31, datë 30 prill 2008, ndryshuar me Vendimin Nr. 59 dhe Nr. 61, datë 29 gusht 2008 dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 47, datë 10 qershor 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 62 datë 14 shtator 2014 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë).

3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Grupi e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjoneve:

Kategoria e huasë	Provigjoni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjonin për huatë e këqija; shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Grupi nuk përllogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbartur e huave, për të cilat nuk përllogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjonin për humbjet e pritshme. Provigjoni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

3.6 Qiraja financiare

Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi, dhe kështu arkëtimet e qirasë së pagueshme janë trajtuar nga Grupi si shlyerje të principalit dhe të të ardhurës financiare për të rimbursuar dhe shpërblyer investimin dhe shërbimin e Grupit. Çdo marrëveshje tjetër qiraje, përveç qirasë financiare klasifikohet si qira e zakonshme.

Shumat për t'u marrë nga qiramarrësit njihen si të arkëtueshme me vlerën e investimit neto të Grupit në qiranë financiare.

Kostot fillestare të drejtpërdrejta bëra nga Grupi janë të përfshira në matjen fillestare të qirasë financiare të arkëtueshme dhe për të zvogëluar sasinë e të ardhurave të njohura gjatë afatit të qirasë. Norma e interesit e nënkuptuar në qira është përcaktuar në mënyrë të fillë që kostot fillestare të drejtpërdrejta përfshihen automatikisht në qiranë financiare të arkëtueshme, nuk ka nevojë të shtoni ato veç e veç.

E ardhura financiare shpërndahet në çdo periudhë gjatë jetës së qirasë në mënyrë që të prodhojë normë interesi konstante mbi shumën e mbetur të aktivit. Pagesat e qirasë që lidhen me periudhën, me përjashtim të shpenzimeve për shërbime, janë aplikuar kundër investimit bruto në qira për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurën financiare të pafitur.

Pagesat minimale të qirasë nën qiratë financiare shpërndahen ndërmjet të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktiveve të mbetura.

Pagesat e mundshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar minimumin e pagesave të qirasë mbi jetën e mbetur të qirasë kur konfirmohen rregullimet.

3.7 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Prona, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara

Toka dhe ndërtesa shprehen me vlerë të rivlerësuar minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, ndërsa aktivet e tjera shprehen me kosto historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

3.7 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (vazhdim)

Zhvlërësimi dhe amortizimi janë paraqitur si pakësim i kostos së pronës, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim, dhe duke aplikuar përqindjet e zhvlërësimit dhe amortizimit si më poshtë:

Kategoria	Normat e amortizimit
Ndërtesa	20 vjet
Automjete	7 vjet
Kompjutera dhe pajisje informatike	4 deri në 7 vjet
Software dhe Licenca	8 vjet
Makineri dhe sisteme	7 vjet
Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7 vjet
Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10 vjet

Toka dhe punimet në proçes nuk zhvlërësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

3.8 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlogaritjeje.

3.9 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlogaritjeje.

3.10 Interesat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përlogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

3.11 Shpenzimet

(i) Shpenzimet operative

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

(ii) Përfitimet e punonjësve

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimim e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimim e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

3.11 Shpenzimet (vazhdim)

(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

3.12 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin më 30 Shtator 2024 llogaritet 15% (31 dhjetor 2023: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

3.13 Pjesëmarrje në filial

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë rezultatin e Raiffeisen Leasing Sh.a. dhe nuk përfshijnë rezultatin dhe aktivet neto të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. Investimi në këtë filial është raportuar me kosto.

3.14 Vlerësimi i vlerës së tregut

Duke qenë se për instrumentat financiare të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiare të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Grupit kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose riçmohen brenda vitit.

3.15 Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

3.16 Krahasueshmëria

Politikat kontabël të adoptuara nga Grupi janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

Treguesit e rentabilitetit të Grupit Raiffeisen

Treguesit e rentabilitetit*	30/09 2024	30/06 2024	31/03 2024	31/12 2023	30/09 2023
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) = të ardhurat neto / aktivet mesatare *100;	2.7%	2.8%	2.6%	2.6%	2.4%
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	24.7%	25.2%	28.2%	23.5%	24.4%
4. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) = të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100;	22.6%	23.5%	22.5%	21.7%	19.6%
5. Aktive për punonjës: = totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve;	223,797	222,764	224,631	232,645	227,325
6. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	12.6%	12.5%	13.0%	11.8%	12.2%

(*) Treguesit janë llogaritur sipas kërkesave të Rregullores Nr. 4, datë 1.2.2017 "PËR MBIKËQYRJEN E KONSOLIDUAR".

Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilancit të Grupit Raiffeisen

Aktivët në mijë Lekë	30/09 2024	31/12 2023	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/09 2024	30/06 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	35,476,563	41,876,906	-6,400,344	-15.3%	35,476,563	39,964,810	-4,488,247	-11.2%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	23,909,549	28,097,371	-4,187,821	-14.9%	23,909,549	24,467,216	-557,667	-2.3%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	26,937,226	28,503,161	-1,565,934	-5.5%	26,937,226	27,467,935	-530,709	-1.9%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	125,952,653	123,153,933	2,798,720	2.3%	125,952,653	120,946,111	5,006,542	4.1%
Letra me vlerë	80,251,665	76,667,571	3,584,094	4.7%	80,251,665	78,879,528	1,372,138	1.7%
Investime në filiale	109,648	109,648	-	0.0%	109,648	109,648	-	0.0%
Mjetet e trupëzuara	3,146,328	3,341,697	-195,370	-5.8%	3,146,328	3,228,481	-82,154	-2.5%
Mjetet e patrupëzuara	2,090,285	2,196,828	-106,543	-4.8%	2,090,285	2,127,567	-37,282	-1.8%
Mjete të tjera	2,908,887	2,911,191	-2,305	-0.1%	2,908,887	2,871,215	37,672	1.3%
Totali aktiveve	300,782,804	306,858,307	-6,075,502	-2.0%	300,782,804	300,062,511	720,294	0.2%
DETYRIMET në mijë Lekë	30/09 2024	31/12 2023	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/09 2024	30/06 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	-	-	-	0.0%	-	-	-	0.0%
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	3,594,579	-	3,594,579	0.0%	3,594,579	2,730,055	864,524	31.7%
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	7,180,392	9,367,294	(2,186,902)	-23.3%	7,180,392	8,929,113	(1,748,721)	-19.6%
Detyrimet ndaj klientëve	243,923,490	251,862,063	(7,938,573)	-3.2%	243,923,490	242,261,118	1,662,372	0.7%
Detyrimet ndaj qeverisë dhe organizatave publike	346,632	354,045	(7,413)	-2.1%	346,632	335,241	11,391	3.4%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	1,932,256	2,170,713	(238,456)	-11.0%	1,932,256	2,103,305	(171,049)	-8.1%
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	1,407,828	1,396,328	11,500	0.8%	1,407,828	1,359,569	48,258	3.5%
Borxh i varur	2,002,371	2,106,945	(104,574)	-5.0%	2,002,371	2,034,242	(31,871)	-1.6%
Tatimi fitimi për t'u paguar	590,165	697,641	(107,476)	-15.4%	590,165	420,993	169,172	40.2%
Detyrime të tjera	3,899,351	4,376,402	(477,051)	-10.9%	3,899,351	3,550,661	348,690	9.8%
Kapitali aksionar	35,905,741	34,526,876	1,378,865	4.0%	35,905,741	36,338,213	(432,472)	-1.2%
Kapitali i paguar	14,178,593	14,178,593	(0)	0.0%	14,178,593	14,178,593	(0)	0.0%
Rezerva	4,737,681	4,805,501	(67,820)	-1.4%	4,737,681	4,760,287	(22,607)	-0.5%
Diferenca e rivlerësimit	(3,974,300)	(3,716,767)	(257,533)	6.9%	(3,974,300)	(3,896,687)	(77,613)	2.0%
Fitimi (humbja) i pashpërndarë	14,905,894	11,663,031	3,242,863	27.8%	14,905,894	17,070,105	(2,164,211)	-12.7%
Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor	6,057,873	7,596,518	(1,538,646)	-20.3%	6,057,873	4,225,915	1,831,958	43.4%
Interesa të pakicës	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	300,782,804	306,858,307	-6,075,502	-2.0%	300,782,804	300,062,511	720,294	0.2%
Zërat jashtë bilancit mijë Lekë	30/09 2024	31/12 2023	Ndryshimi YTD absolut	Ndryshimi YTD ne %	30/09 2024	30/06 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Angazhime dhe garanci të dhëna	33,050,317	31,006,575	2,043,742	6.6%	33,050,317	33,826,550	-776,233	-2.3%
Angazhime garanci të marra	723,925	714,809	9,116	1.3%	723,925	737,572	-13,646	-1.9%
Transaksione në valutë	14,180,430	5,229,589	8,950,840	171.2%	14,180,430	7,849,706	6,330,724	80.6%
Angazhime të tjera	-	-	-	0%	-	-	-	0%

Shënimi: Shifrat janë të pa audituara nga auditorët e jashtëm

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	1/1-30/09 2024	1/1-30/09 2023	Ndryshimi YoY absolut	Ndryshimi YoY ne %	Tremujori-3 2024	Tremujori-2 2024	Ndryshimi tremujor absolut	Ndryshimi tremujor ne %
Të ardhurat nga interesat	7,397,677	6,808,753	588,925	8.6%	2,461,081	2,483,210	-22,130	-0.9%
Shpenzimet për interesa	-550,725	-149,560	-401,165	268.2%	-187,647	-180,389	-7,258	4.0%
Te Ardhurat Neto nga Interesat	6,846,953	6,659,193	187,760	2.8%	2,273,434	2,302,822	-29,388	-1.3%
Të ardhura nga operacionet financiare	3,183,565	2,500,928	682,637	27.3%	1,067,348	1,116,332	-48,984	-4.4%
Humbje nga operacionet financiare	-327,951	-246,086	-81,865	33.3%	-190,486	-67,759	-122,726	181.1%
Fitimi neto nga veprimet financiare	2,855,614	2,254,842	600,772	26.6%	876,862	1,048,573	-171,711	-16.4%
Te ardhurat nga komisionet	3,461,723	3,216,996	244,728	7.6%	1,295,480	1,125,190	170,290	15.1%
Shpenzime per komisionet	-1,544,831	-1,441,853	-102,978	7.1%	-620,993	-469,703	-151,290	32.2%
Fitimi Neto nga Komisionet	1,916,893	1,775,143	141,750	8.0%	674,487	655,487	19,000	2.9%
Të ardhurat nga veprimet e qirasë, neto	736	850	-114	-13.4%	-18	-413	395	-95.6%
Të ardhura të tjera të veprimtarisë bankare, neto	-428,837	-93,613	-335,225	358.1%	-72,271	-282,293	210,021	-74.4%
Fitime nga veprimet me valutat, neto	973,336	-262,363	1,235,700	-471.0%	360,334	374,817	-14,482	-3.9%
Të ardhura neto nga veprimtaria bankare	12,164,694	10,334,053	1,830,642	17.7%	4,112,828	4,098,993	13,836	0.3%
Shpenzime për personelin	-2,318,659	-2,088,727	-229,932	11.0%	-796,710	-788,520	-8,190	1.0%
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	-42,028	-41,006	-1,022	2.5%	-2,693	-28,025	25,332	-90.4%
Shpenzime të përgjithshme administrative	-2,193,513	-2,046,748	-146,764	7.2%	-683,455	-661,323	-22,132	3.3%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	-4,554,200	-4,176,481	-377,719	9.0%	-1,482,858	-1,477,869	-4,989	0.3%
Të ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për amortizime dhe për fonde rezervë	7,610,494	6,157,572	1,452,923	23.6%	2,629,971	2,621,124	8,847	0.3%
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	-522,956	465,157	-988,113	-212.4%	-178,497	-174,255	-4,242	2.4%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fondet rezervë statistikore	-18,834	20,228	-39,062	-193.1%	-57,211	-10,870	-46,340	426.3%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	-184,071	-126,675	-57,396	45.3%	-179,083	-84,399	-94,684	112.2%
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	-91,331	-257,146	165,815	-64.5%	-48,058	-29,014	-19,044	65.6%
(Shpenzime)/rimarrje neto për fonde të tjera rezervë	189,966	-168,052	358,018	-213.0%	14,338	176,691	-162,354	-91.9%
Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	194,378	133,293	61,085	45.8%	20,132	83,878	-63,746	-76.0%
Fitimi (Humbja) para tatimit	7,177,646	6,224,376	953,270	15.3%	2,201,592	2,583,155	-381,563	-14.8%
Taksa mbi të ardhurat	-1,119,774	-977,256	-142,518	14.6%	-369,635	-353,998	-15,636	4.4%
Fitimi / (Humbja) neto per periudhen	6,057,873	5,247,121	810,752	15.5%	1,831,958	2,229,157	-397,199	-17.8%

Shenimi: Shifrat janë të pa audituara nga auditoret e jashtëm

Struktura e kapitalit rregullator për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	30/9/2024
KAPITALI RREGULLATOR	32,333,968
KAPITAL I NIVELIT TE PARE	30,358,568
KAPITAL BAZE I NIVELIT TE PARE	30,358,568
Instrumenta të njohura si Kapital Bazë i Nivelit të Parë (KBN1)	14,178,593
Kapitali i paguar	14,178,593
Primet e aksioneve	-
Fitimet e pashpërndara	19,057,018
Fitimet e pashpërndara të mbartura nga periudhat e mëparshme	14,905,894
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	-
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	4,151,124
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	3,297,190
Diferenca rivlerësimi (debitore)/ kreditore	-3,974,300
Rregullime të KBN1 lidhur me filtrat prudencialë	-
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	-2,090,285
(-) Instrumenta të KBN1 ku banka ka investimeve të rëndësishme	-109,648
(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%	-
KAPITALI SHITESI I NIVELIT TE PARE	-
KAPITALI I NIVELIT TE DYTE	1,975,400
Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si KN2	1,975,400
Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	1,975,400

Raportet dhe nivelet e kapitalit për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	Kufijtë	Vlera
Kapitali rregullator	> 1.000.000	32,333,968
Kapitali i nivelit të parë	> 1.000.000	30,358,568
Kapitali bazë i nivelit të parë	> 1.000.000	30,358,568
Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me rrezik	N/A	141,863,880
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (në %)	≥ 12%	22.79
Raporti: Kapitali i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (në %)	≥ 9%	21.40
Raporti: Kapitali bazë i nivelit të parë/Ekspozime të ponderuara me rrezikun (%)	≥ 6.75%	21.40

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për Grupin Raiffeisen

në mijë Lekë	30/9/2024
KAPITALI RREGULLATOR	32,333,968
Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit - RMK - (%) $\geq 12.0\%$	22.79
SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	141,863,880
RREZIKU I KREDISE	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	118,112,210
Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit	118,112,210
<i>Ekspozime ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;</i>	1,216,697
<i>Ekspozime ndaj organizatave joqeveritare /jofitimprurëse;</i>	0
<i>Ekspozime ndaj institucioneve të mbikëqyrura;</i>	3,573,730
<i>Ekspozime ndaj shoqërive tregtare (korporatave);</i>	55,708,097
<i>Ekspozime ndaj portofoleve me pakicë (retail);</i>	40,191,772
<i>Ekspozime të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;</i>	3,888,793
<i>Ekspozime (kredi) me probleme;</i>	2,328,611
<i>Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;</i>	2,594,229
<i>Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;</i>	0
<i>Zëra të tjerë</i>	5,832,382
<i>Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare</i>	2,777,899
<i>Ekspozime të kapitalit</i>	0
RREZIQET E TREGUT	
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	766,138
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	0
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	766,138
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	0
Rreziku i kursit të këmbimit	766,138
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	0
RREZIKU OPERACIONAL	
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	22,985,531
Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	0
Metoda Standarde / Standarde Alternative	22,985,531
Shtesat për rritjen në klasat në "Veprimet me thesarin dhe transaksionet ndërbankare" dhe "Veprimet me letrat me vlerë" të jorezidentëve, në valutë	0